



Prezantimi i paraqitur nga PSBE Pieter Feith para Komitetit për Marrëdhënie të Jashtme të Parlamentit Evropian

11 Shkurt 2009

Duke iu drejtuar Komitetit për Marrëdhënie të Jashtme të Parlamentit Evropian, PSBE Pieter Feith tha:

“Anëtarë të Komitetit, zonja e zotërinj, jam i lumtur që ndodhem sot këtu bashkë me ju dhe t’ju paraqes një vlerësim të progresit që është bërë në konsolidimin e pranive të BE-së në Kosovë, si dhe për nismat që i kam ndërmarrë unë si pjesë e përgjegjësive në kuadër të mandatit tim.

“Takimi ynë vjen në kohë të duhur, jo vetëm për arsye se përmenden përvjetorë, - sepse është në vazhden e miratimit të rezolutës për Kosovën nga Parlamenti Evropian më 5 shkurt dhe të rolit të BE-së. Unë e kam kuptuar këtë rezolutë si shprehje të përkrahjes së plotë të Parlamentit për misionin e BE-së në Kosovë në angazhimet e tij për të punuar me autoritetet e Prishtinës për perspektivën evropiane të Kosovës si pjesë e rajonit, por duke ua përkujtuar autoriteteve të Prishtinës zotimet e tyre, në veçanti për sa i përket forcimit të sundimit të rendit e ligjit dhe vazhdimin të respektimit të të drejtave të pakicave. Unë në mënyrë të veçantë e mirëpres mbështetjen të cilën ma jep mua kjo rezolutë për çështjet themelore, kryesisht decentralizimin, mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore, reformimin e ekonomisë dhe reformimin e sektorit të sigurisë. Pas pak, gjatë këtij prezantimi unë do të flas më hollësisht për to. Përkrahja juaj për këto fusha të rëndësishme të punës me jep mua një shtysë për t’u përpjekur edhe më shumë që të sigurohet një progres sa më i shpejtë gjatë këtij viti dhe më pas.

“Në paragrafin 32 të rezolutës, unë i vura re shqetësimet e Parlamentit lidhur me ritmin e ngadaltë të reformave të ndërmarrë nga autoritetet e Kosovës. Ç’është e vërteta, Qeveria duhet të ndërmarrë hapa të vërtetë në fushat e llogaridhënies dhe transparencës, si dhe në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Po ashtu, ajo duhet t’i forcojë lidhjet ndërmjet spektrit shoqëror dhe politik dhe të sigurojë që fondet e donatorëve publik dhe ndërkombëtarë të shfrytëzohen në mënyrë të përgjegjshme dhe transparente. Të gjitha këto janë elemente qenësore të një klime, e cila do t’i konsolidonte aspiratat e mëtejme evropiane të Kosovës dhe do të ndihmonte

European Union Special Representative (EUSR) ©2008

"Blue Building" St. Ahmet Krasniqi PN (100 metres south of Hotel Adria) 10000 Pristina, Kosovo

Tel: + 381 (0) 38 2044 - 307 (office) + 377 (0) 44 509 760 (call) E-mail: julia.rueter@eusrinkosovo.eu



European Union Special Representative in Kosovo

në përmirësimin e kushteve shoqërore dhe ekonomike në jetën e përditshme të qytetarëve.

“Gjatë vitit të kaluar, Kosova e ka miratuar Kushtetutën, ka miratuar ligje të rëndësishme, ka forcuar ministritë kryesore të Qeverisë, ka përparuar në themelimin e Gjykatës Kushtetuese, si dhe të institucioneve publike tjera të sigurisë dhe ka dëshmuar se është një partner bashkëpunues i bashkësisë ndërkombëtare. Të gjitha këto zhvillime janë shënuar duke e pasur në prapavijë një gjendje relativisht stabile të sigurisë. Në dhjetor të vitit të kaluar, EULEX-i e filloi misionin e tij në tërë Kosovën duke shënuar një hapërim të madh drejt angazhimit të Bashkimit Evropian si partner kryesor i Qeverisë së Kosovës.

“Elani që u krijua na ka ndihmuar që të bëhen hapa të mëdhenj në ato që unë i kam përkufizuar si tri fushat kryesore për punën tonë gjatë këtij viti dhe në të ardhmen— stabiliteti, reformat dhe pajtimi. Unë do t'i trajtoj me radhë këto objektiva strategjike dhe pastaj do ta mbyll fjalën duke i propozuar mënyrat më të mira për t'i arritur ato në partneritet me autoritetet e Kosovës.

“Qëndrueshmëria e të gjitha iniciativave varet krejtësisht nga stabiliteti i vazhdueshëm politik në Kosovë. Siç e thashë tashmë, derisa gjendja në Kosovë ishte stabile gjatë vitit të kaluar, reagimet politike në Prishtinë ndaj bisedimeve të udhëhequra nga OKB-ja për gjashtë pikat, si dhe ngjarjet e paradokohshme në Mitrovicë nxjerrin në pah brishtësinë e vazhdueshme të gjendjes në terren.

“Unë, si PS i BE-së, e kam krijuar një mekanizëm lokal për konsultime transparente për çështjet me rëndësi praktike, duke i përfshirë temat e përmendura në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së të nëntorit 2008. Ky bashkërendim i bashkon të gjithë hisedarët ndërkombëtar si EULEX-in, KFOR-in, UNMIK-un dhe Komisionin Evropian. Ne jemi takuar rregullisht për të propozuar zgjidhje programore për çështjet praktike me interes për Beogradin dhe për Prishtinën. Këtu përfshihen, mes tjerash, arkëtimi dhe shpërndarja e të hyrave doganore, funksionimi i gjykatës në Mitrovicë, çështja e ligjeve të zbatueshme dhe qarkullimi i trenave në Veri.

“Unë besoj fuqishëm se, duke i mbajtur diskutimet në nivel teknik, duke promovuar standardet dhe praktikat më të mira evropiane, si dhe duke i përfshirë nga afër Brukselin dhe hisedarët përkatës vendorë dhe ndërkombëtar, mund të arrihen rezultate në të paktën disa prej këtyre fushave. Kjo është pjesë e bashkërendimit dhe bashkëpunimit të ngushtë me Shefin e Misionit të EULEX-it, de Kermanbon, çka edhe ju më keni inkurajuar ta bëj me anë të rezolutës suaj.

European Union Special Representative (EUSR) ©2008

"Blue Building" St. Ahmet Krasniqi PN (100 metres south of Hotel Adria) 10000 Pristina, Kosovo

Tel: + 381 (0) 38 2044 - 307 (office) + 377 (0) 44 509 760 (call) E-mail: julia.rueter@eusrinkosovo.eu



European Union Special Representative in Kosovo

“Meqë e ardhmja evropiane i bashkon Beogradin dhe Prishtinën dhe BE-në, meqë BE-ja ka marrë rolin prijës, ne mund të jemi në situatë shumë të mirë për të ofruar një kanal komunikimi ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Nëse qëllimi është arritja e rezultateve pozitive, atëherë ne tashmë i kemi instrumentet për të ndihmuar në arritjen e një rezultati të tillë. Sidoqoftë, objektivi i përgjithshëm mbetet kontaktet e mira e të drejtëpërdrejta ndërmjet të dy palëve.

“Ky angazhim do t'i ndihmojë edhe EULEX-it që sa më shpejt t'i arrijë kapacitetet e plota për funksionim në tërë Kosovën. Kjo nevojë, krahas çështjes së forcimit të rendit dhe ligjit, është diskutuar rregullisht nga Kryeministri dhe liderët opozitarë në paraqitjet e tyre publike dhe në takimet private me mua. Ngjarjet e dhunshme gjatë festave të Krishtlindjeve dhe demonstratat e djeshme në Mitrovicë, theksojnë nevojën për të ecur me shpejtësi përpara, veçmas në Veri.

“Në këtë kontekst, duhet trajtuar çështjet e rëndësishme lidhur me strukturat paralele dhe arrestimin e kriminelëve të njohur. Përgjigjet në këto çështje do të ndikojnë në besueshmërinë e Bashkimit Evropian dhe gatishmërinë e tij për t'u përballur me detyrat e vështira, mbase të rrezikshme, për ta integruar Veriun dhe për ta normalizuar gjendjen atje duke e bërë atë pjesë të një hapësire të vetme juridike dhe doganore në bazë të praktikave më të mira evropiane. Qytetarët në Kosovë presin jashtëzakonisht shumë nga Bashkimi Evropian. Nuk mund t'ia lejojmë vetes të dështojmë në realizimin e përgjegjësive tona.

“Në nivelin politik, ku Vendet Anëtare të Bashkimit Evropian e kanë një rol të rëndësishëm për ta luajtur, një mbështetje më intensive dhe më e mirë e Beogradit për punën e misioneve të BE-së në terren është vendimtare, veçanërisht për sa i përket një qëndrimi më bashkëpunues nga kryetarët e komunave në Veri dhe në izolimin e elementëve kriminalë ekstremistë në Veri.

“Në këtë drejtim, unë besoj se vendimi i Kryetarit të Kosovës për të mos i mbajtur zgjedhjet këtë vit do të ndihmojë në ruajtjen e stabilitetit të gjendjes politike në Kosovë. Përkitazi me zgjedhjet komunale, të cilat ka gjasa të mbahen kah fundi i këtij viti, deri më tani nuk është marrë ndonjë vendim i prerë lidhur me kohën e mbajtjes së tyre. Progresi në decentralizim dhe siguri i pjesëmarrjes së serbëve do të jenë elemente të rëndësishme kur të vendoset për kohën e saktë. Një parakusht tjetër është funksionimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Konsultimet ndërmjet hisedarëve përkatës janë duke vazhduar. Qeveria me padurim pret që sa më shpejtë ta bëjë regjistrimin e plotë të popullsisë në tërë Kosovën. Unë do të konsultohem me

European Union Special Representative (EUSR) ©2008

"Blue Building" St. Ahmet Krasniqi PN (100 metres south of Hotel Adria) 10000 Pristina, Kosovo

Tel: + 381 (0) 38 2044 - 307 (office) + 377 (0) 44 509 760 (call) E-mail: julia.rueter@eusrinkosovo.eu

autoritetet lidhur me kohën e mbajtjes së tij. Regjistrimi testues i paradokohshëm ka arritur një pjesëmarrje prej 71 % të serbëve të Kosovës. Ne dëshirojmë të sigurojmë një pjesëmarrje edhe më të madhe të pakicave në regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë.

“Kuvendi i Kosovës, që nga themelimi i tij, ka luajtur një rol kryesor në zhvillimin institucional të Kosovës. Përveç miratimit të dokumenteve themelore dhe ratifikimit të kushtetutës së vendit, ai, po ashtu, ka qenë një aktor kryesor në angazhimet e institucioneve të Kosovës për të zbatuar më shumë se 50 ligje me theks të posaçëm në të drejtat e pakicave. Megjithatë, unë besoj se Kuvendi edhe më tej nuk po arrin ta përmbush rolin kryesor të tij, atë të ofrimit të forumit kryesor për debat politik dhe mbikëqyrje dhe shqyrtim parlamentar. Shumë vendime vazhdojnë të merren nga Qeveria pa ndonjë përfshirje të konsiderueshme të Kuvendit. Dhe shumë prej komunikimeve politike kanalizohen nëpërmjet shtypit dhe ka mundësi edhe në rrugë. Meqë vazhdon të mbetet një institucion i ri dhe në zhvillim, atij i nevojitet mbështetja jonë e plotë dhe e vazhdueshme.

“Përderisa vendimin për mos mbajtjen e zgjedhjeve e mori Kryetari, unë ndjehem më se i sigurt kur them se shmangia e zgjedhjeve të përgjithshme gjatë këtij viti eliminon një çorientim të madh dhe ndihmon që mendja e Qeverisë dhe legjislaturës të përqendrohen në reformat e gjëra të domosdoshme për ta vënë Kosovën në një pozitë të volitshme që do të jetë shumë e rëndësishme për progresin e mëtejshëm.

“Për fillim, zonja dhe zotërinj, Qeveria ka premtuar privatizimin e kompanive në pronësi shtetërore, por për këtë i duhet që ta formulojë strategjinë. Disa plane fillestare janë publikuar lidhur me prodhuesin dhe ofruesin kryesor të rrymës (KEK-u), pastaj për postën dhe telekomunikacionin, si dhe për aeroportin. Këto plane duhet të shpejtojnë përpara më fuqishëm. Mirëpo, recesioni aktual global mund të ndikojë negativisht në interesimin për IDJ (Investimet e Drejtpërdrejta të Jashtme) për Kosovën. Në aspektin e përgjithshëm, autoritetet e Kosovës duhet t'i menaxhojnë ndërmarrjet shoqërore në mënyrë transparente dhe të bëjnë emërimet e nevojshme në bordet e tyre në bazë të meritave dhe kompetencës e jo në bazë të preferencave politike apo partiake.

“Në sferën e reformimit të sektorit të sigurisë, më 20 janar u bë shpërbërja e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, kurse Forca e Sigurisë së Kosovës u aktivizua mëpastaj. Ky proces, siç është theksuar edhe në rezolutën tuaj, do të mundësojë krijimin e një force të vogël por të kualifikuar të sigurisë me detyra mbrojtjeje civile e që do t'i nënshtrohet kontrollit demokratik. Megjithatë, përzgjedhja e pjesëtarëve të FSK-së ka gjasa të



European Union Special Representative in Kosovo

shkaktojë pakënaqësi të mëtejme të ish-pjesëtarët e TMK-së, gjë që mund të sjellë tensionime të mundshme.

“Z. Kryetar, tani do flas për prioritetin e tretë – nevojën për përkushtim të vazhdueshëm për procesin e pajtimit në mes të komuniteteve të ndryshme të Kosovës. Siç më keni kërkuar të veprojmë në rezolutën tuaj, unë i inkurajojmë dhe i mbështesim udhëheqësit e Kosovës për shtimin e përpjekjeve të tyre për t’ia shtrirë dorën serbëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera joserbe. Në të vërtetë, tani mund të ketë mundësi që gjithnjë e më shumë serbë të jenë të gatshëm të afrohen dhe të kyçen në institucionet qendrore. Një tryezë e rrumbullakët e mbajtur kohëve të fundit e filloi me sukses dialogun për çështje konkrete siç janë shëndetësia dhe arsimiti. Kryeministri dhe ministrat kyç morën pjesë dhe do të vazhdojnë të mbesin të angazhuar për këtë çështjeohen. Udhëheqësit serbë të Kosovës, duke përfshirë edhe ata nga Veriu, kanë shprehur gatishmërinë që të mbështesin këtë iniciativë të udhëhequr nga EUSR-ja.

“Në fushën me rëndësi të veçantë të Trashëgimisë Fetare dhe Kulturore, tashmë janë arritur disa suksese. Ne kemi punuar shumë ngushtë me Ministrinë e Kulturës si dhe me Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian për themelimin e një forumi për Shkëmbimin e Informacioneve Teknike në këtë fushë. Në të vërtetë, në pajtim me Partneritetin Evropian ne përqipemi të forcojmë edhe më tej mekanizmat që shërbejnë për mbrojtjen e trashëgimisë së pasur fetare dhe kulturore në Kosovë. Takimi i parë i këtij forumi që u mbajt para dy tre javësh bashkoi një varg aktorësh të fushës së trashëgimisë kulturore, përfshirë UNMIK-un dhe Këshillin e Evropës, duke mundësuar kështu EUSR-it që të udhëheq me agjendën politike. Pas këtij takimi inaugurues, është vendosur që ky proces të vazhdojë, por ai do të përfitonte më shumë nga pjesëmarrja ose së paku ndonjë formë e mbështetjes nga autoritetet serbe dhe nga Kisha Ortodokse Serbe.

“Autoritetet po ashtu do të vazhdojnë të arrijnë progres edhe në përgatitjen e decentralizimit. Para disa ditësh, Kryeministri lajmëroi se kompetencat për mirëqenien sociale do t’i barten nivelit komunal dhe se deri në fund të marsit do të caktohen ekipet përgatitore për themelimin e pesë komunave të reja. Po ashtu ka filluar edhe puna në reformën e arsimit dhe në zhvillimin e planprogrameve shkollore në gjuhën serbe.

“Z. Kryetar, edhe unë kam të njëjtat shqetësime me ato që keni ngritur ju në rezolutën tuaj në lidhje me kthimin e pakicave dhe personave të zhvendosur dhe në jemi duke i trajtuar këto në mënyrë të vazhdueshme me autoritetet. Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve e ka rritur buxhetin e saj të vitit 2009 për 3.3 milionë euro për dy vitet e ardhshme dhe në bashkëpunim me UNDP-në do të mbështesë procesin e kthimeve

European Union Special Representative (EUSR) ©2008

"Blue Building" St. Ahmet Krasniqi PN (100 metres south of Hotel Adria) 10000 Pristina, Kosovo

Tel: + 381 (0) 38 2044 - 307 (office) + 377 (0) 44 509 760 (call) E-mail: julia.rueter@eusrinkosovo.eu



European Union Special Representative in Kosovo

individuale. Ministria ka ndarë fonde shtesë për zhvillim, arsim dhe banim për komunitetet si dhe për kthimin e komuniteteve. Edhe pse mjetet e ndara janë modeste, qeveria është plotësisht e përkushtuar që të punojë shumë në këtë fushë. Mbesin disa sfida në krijimin e mjedisit të përshtatshëm për kthime në shkallë më të lartë dhe për reintegrim të duhur të komuniteteve pakicë në jetën e përditshme në Kosovë. Ne do të vazhdojmë përpjekjet për adresimin e këtyre çështjeve në bashkëpunim me autoritetet.

“Sa i përket çështjes specifike të gjendjes së komunitetit romë të prekur nga helmimi me plumb në pjesën veriore, unë e mbështesë fuqishëm një proces të qëndrueshëm politik të udhëhequr nga qeveria për të mbyllur kampet dhe për të zhvendosur romët në zona të sigurta ku do të kenë kushte të mira sanitare. Për momentin, ky proces është duke hasur në pengesa për shkak të mungesës së komunikimit ndërmjet aktorëve përkatës në Veri dhe në Jug, dhe për shkak të gjendjes së paqartë politike në Veri. Tani, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Prishtinë është duke bashkërenduar palët vendore dhe ndërkombëtare të interesit për gjetjen e një zgjidhjeve të qëndrueshme dhe afatgjata.

“Në mbyllje, në vitin që e kemi përpara na pret një agjendë ambicioze dhe e madhe për Kosovën dhe Bashkësinë Ndërkombëtare, veçanërisht për Bashkimin Evropian. Por, unë besoj se me një vullnet politik, bashkërendim dhe inkurajim të mjaftueshëm, Qeveria e Kosovës do të jetë në gjendje të përparojë në aspiratat e saja evropiane. Nga ajo që e thashë, ekzistojnë dëshmi të shumta që përgjegjësitë e mija të dyfishta në Kosovë janë rritur duke e mbështetur njëra tjetrën në mënyrë të ndërsjellë, prandaj jam në gjendje që të flas për aspektet e ndryshme me kompetencën e duhur dhe me mundësi më të mëdha për t'i arritur objektivat të cilat i kam përcaktuar.

“Edhe një herë dëshiroj t'ju falënderoj për mbështetjen tuaj dhe për rezolutën e fuqishme, e cila e ka shtuar entuziazmin dhe elanin tim dhe të ekipit tim në punën tonë që t'i ndihmojmë popullit të Kosovës në mënyrën më të mirë të mundshme.

“Ju faleminderit shumë.”

Fund.